

Vendim nr. 137 datë 21.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 21.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (K) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **KUJTIM SULAJ**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-568 (21), datë 18.01.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 124, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shoqëria “Unioni Financiar Tiranë” ka lidhur disa kontrata me shoqërinë e sigurimit “INSIG” sh.a., për të siguruar degët dhe agjencitë e saj në të gjithë territorin e Shqipërisë, mes të cilave edhe agjencinë e këmbimit valutor “Dini” me qendër në Cakran të Fierit, me administrator shtetasin Kujtim Sulaj (kërkuesi).

2. Në datën 01.10.2009, në fshatin Cakran të Fierit ka ndodhur një vjedhje me thyerje në agjencinë “Dini” dhe pas përfundimit të hetimeve Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka vendosur pezullimin e tyre, duke e konsideruar ngjarje pa autor dhe ia ka kthyer policisë së Fierit për hetime të mëtejshme për zbardhjen e saj.

3. Shoqëria “Unioni Financiar Tiranë”, me shkresën nr. 510 prot., datë 01.10.2009, ka njoftuar shoqërinë “INSIG” sh.a. për dëmin e ndodhur në agjencinë “Dini”, nga vjedhja me thyerje, të vlerave monetare 4,500 euro dhe 520,000 lekë. Shoqëria “INSIG” sh.a. i ka kthyer përgjigje se agjencia “Dini” nuk ka plotësuar kushtet e kontratës CIS, neni 25, shkronjat “a” dhe “b”. Sipas saj, i siguruari nuk ka plotësuar detyrimet e tij, pasi nga pakujdesia nuk e ka parandaluar dëmin, por duke lënë çelësin e kasafortës në ambientet e agjencisë ka ndihmuar në kryerjen e tij. Në këto kushte është refuzuar kërkesa për dëmshpërblim. Në këto kushte, kërkuesi dhe shoqëria “Unioni Financiar Tiranë”, i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e të paditurës “INSIG” sh.a. të paguajë shpërblimin për dëmin pasuror.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10932, datë 04.11.2013, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesi dhe shoqëria “Unioni Financiar Tiranë”.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 3705, datë 11.11.2014, ka vendosur të ndryshojë vendimin nr. 10932, datë 04.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pranuar padinë dhe duke vendosur detyrimin e shoqërisë “INSIG” sh.a. të dëmshpërblejë paditësit për shumat 4,500 euro dhe 520,000 lekë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë pala e paditur në procesin gjyqësor, shoqëria “INSIG” sh.a.

6. Kolegji Civil të Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-568 (21), datë 18.01.2023, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 3705, datë 11.11.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 10932, datë 04.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas tij, Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka interpretuar drejt dispozitat ligjore materiale dhe procedurale, ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka analizuar drejt dispozitat ligjore në raport me provat e paraqitura, duke konkluduar se kërkimet e paditësit nuk qëndrojnë.

7. Në datën 24.04.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të mësipërm.

II

Pretendimet e kërkuetit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt, në drejtim të:

- 8.1. *Së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar*, pasi në kushtet kur nga ana e palës së paditur në procesin gjyqësor është ushtruar rekurs, një kopje e tij duhej t'i ishte dorëzuar kërkuesit, në mënyrë që ai, në përputhje me dispozitat ligjore, të ushtronte kundërrkurs, nëpërmjet të cilit të parashtronte argumentet e tij se përse Gjykata e Lartë duhej të vendoste mospranimin e rekursit. Duke mos kryer këtë njoftim dhe duke qenë se kërkuesi ishte në pamundësi të marrjes dijeni, gjykata ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor.
- 8.2. Edhe njoftimet e bëra nga gjykata për seancën gjyqësore janë në kundërshtim me kërkesat dhe urdhërimet e neneve 119-124 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), pasi që nga koha e dhënies së vendimeve të gjykatave të faktit kanë kaluar rreth 9 vjet, për rrjedhojë ato duhej të ishin kryer me fletëthirrje, pasi kërkuesi nuk mund të kontrollonte listat e gjykimeve të shpallura në internet për një kohë kaq të gjatë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues.

11. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja

“f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Në lidhje me kriterin tjetër paraprak të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për rrjedhojë nuk ka mjete të tjera juridike për të shteruar para vënies në lëvizje të gjykimit kushtetues.

13. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, i cili ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë mban datën 18.01.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 24.04.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të njoftimit të tij për rekursin e palës tjetër, ashtu edhe në lidhje me njoftimet e Gjykatës së Lartë për zhvillimin e seancës gjyqësore. Për rrjedhojë, këto pretendime do të trajtohen në vijim në këndvështrim të parimit të barazisë së armëve të lidhur me të drejtën për t’u njoftuar.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve të lidhur me të drejtën për t’u njoftuar

15. Sipas kërkuesit, në kushtet kur nga ana e palës së paditur në procesin gjyqësor është ushtruar rekurs, një kopje e tij duhej t’i ishte dorëzuar kërkuesit, në mënyrë që ai, në përputhje me dispozitat ligjore, të ushtronte kundërrekurs, nëpërmjet të cilit të parashtronte argumentet e tij se përse Gjykata e Lartë duhej të vendoste mospranimin e rekursit. Duke mos kryer këtë njoftim dhe duke qenë se kërkuesi ishte në pamundësi të marrjes dijeni, gjykata ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor. Ai ka pretenduar, gjithashtu, se njoftimet e bëra nga gjykata për seancën gjyqësore janë në kundërshtim me kërkesat dhe urdhërimet e neneve 119-124 të KPC-së, pasi që nga koha e dhënies së vendimeve të gjykatave të faktit kanë kaluar rreth 9 vjet, për rrjedhojë ato duhej të ishin kryer me fletëthirrje, sepse kërkuesi nuk mund të kontrollonte listat e gjykimeve të shpallura në internet për një kohë kaq të gjatë.

16. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerëve. Konkretisht, e drejta për t’u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat

e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklaramit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 22, datë 22.09.2022; nr. 8, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Kolegji, referuar dispozitave procedurale për njoftimin e ankimit në fuqi në kohën e paraqitjes së rekursit, vëren se sipas nenit 476 të KPC-së, rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, në afatin prej 30 ditësh nga njoftimi që u është bërë palëve, duke përcaktuar edhe dokumentet shoqëruese. Neni 477 parashikon se pala kundër së cilës është paraqitur rekursi, mund ta kundërshtojë atë me kundërrekurs, i cili duhet t'i njoftohet atij që ka bërë rekursin në vendbanimin e tij brenda 20 ditëve nga njoftimi i rekursit. Në lidhje me njoftimin e ankimit, neni 447 i KPC-së parashikon se ai u njoftohet palëve sipas rregullave të parashikuara në Kreun IV të Titullit VI të Pjesës I të këtij Kodi, për njoftimet e thirrjet në gjykatë, konkretisht nenet 128 e vijues, që parashikojnë mënyrat e njoftimit të akteve. Kurse sipas nenit 97 të KPC-së, kur palët përfaqësohen në gjykim nga përfaqësuesi, ky mund të kryejë dhe të marrë në interes të palës së vetë të gjitha aktet që i nevojiten procesit, që ligji nuk e ndalon.

19. Kolegji konstaton se sipas akteve të dosjes gjyqësore të administruar për nevoja të këtij shqyrtimi, Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të paraqitur nga

pala e paditur në procesin gjyqësor, pala gjyqumbëse, shoqëria “INSIG” sh.a. Rekursi i kësaj pale rezulton t’i jetë komunikuar avokatit A.Sh., sipas dëftesës së komunikimit nr. 10932, datë 23.12.2014, i cili, sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 11.11.2014 të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë, ka qenë përfaqësues me prokurë i kërkuarit në atë gjykim. Për rrjedhojë, komunikimi i këtij akti i është bërë përfaqësuesit të kërkuarit në përputhje me nenin 97 të KPC-së dhe në ankimin kushtetues kërkuar nuk ka paraqitur asnjë pretendim në lidhje me tagrat dhe të drejtat e këtij përfaqësuesi apo edhe mënyrën e njoftimit të rekursit mbrojtësit të zgjedhur prej tij.

20. Në lidhje me procedurat e gjykimit civil në Gjykatën e Lartë, Kolegji vëren se sipas rregullave proceduralë në fuqi në kohën e shqyrtimit të rekursit, neni 482 i KPC-së parashikon se shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit. Sipas pikës 3 të këtij neni, sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve, të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit. Njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit.

21. Gjykata ka theksuar se në çdo çështje të veçantë, duke pasur parasysh edhe të gjithë procedurën që mund të jetë ndjekur, ajo vlerëson nëse një kufizim ose shkelje gjatë kësaj procedure ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes dhe ia ka bërë palës të pamundur mbrojtjen dhe zhvillimin e procesit gjyqësor në mënyrë të drejtë (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 7, datë 28.02.2000 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Kolegji, referuar akteve të dosjes gjyqësore, konstaton se në datën 22.11.2022 gjyqtarja relatore ka caktuar shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në datën 18.01.2023, duke urdhëruar sekretarinë e gjykatës të kryejë veprimet sipas nenit 482, pika 2, të KPC-së. Sipas të dhënave të publikuara në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “Çështje të shpallura për gjykim”, “Çështje civile për shqyrtim në dhomë këshillimi”, në datën 28.12.2022 është shpallur lista e çështjeve civile për shqyrtim në dhomë këshillimi në datën 18.01.2023, si dhe përbërja e trupit gjykues, ku përfshihet edhe çështja e kërkuarit. Po kështu, në dosjen gjyqësore gjendet e administruar edhe lista e çështjeve civile për shqyrtim në dhomë këshillimi në datën 18.01.2023, ku përfshihet edhe çështja e kërkuarit. Sipas procesverbalit të dhomës së këshillimit të kësaj date, trupi gjykues ka konstatuar se palët në proces kanë marrë dijeni rregullisht, sipas ligjit, me anë të njoftimit me shpallje publike dhe nuk kanë paraqitur ndonjë kërkesë procedurale për përbërjen e trupit gjykues.

23. Për sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se gjykatat kanë vepruar në përputhje me dispozitat procedurale që rregullojnë mënyrën e njoftimit të akteve palëve në gjykim dhe njoftimit për datën e zhvillimit të seancës gjyqësore.

24. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve i lidhur me të drejtën për t'u njoftuar është haptazi i pabazuar.

25. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.